



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1164 prot.

Tiranë, më 03.08.2021

V E N D I M

Nr. 142, datë 03. 08. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 82, datë 04.05.2021, të S. L., në cilësinë e Drejtores Ekzekutive të Fondacionit “Së Bashku”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ) dhe Bashkisë Tiranë.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Misioni i Fondacionit “Së Bashku”, është të promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar dhe lokal. Fokusohet veçanërisht në të drejtat për aksesueshmëri dhe jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar, por gjithashtu merret edhe me arsimin gjithëpërfshirës, pjesëmarrjen në jetën publike, etj.

Subjekti ankues, në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) informon se në ditën e zgjedhjeve për Kuvend, datë 25.04.2021 është paraqitur pranë qendrës së saj të votimit nr. 1887/1 në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi”. Problematika që ajo hasi citohet si më poshtë:

1. Rampa në hyrje të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” ishte jashtë çdo standardi teknik që parashikohet në Rregulloren “Për përshatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuar”. Pra, rampa ishte shumë e pjerrët dhe për rrjedhojë e papërdorshme dhe e rrezikshme. Ankueses i është dashur ndihma e tre personave të cilët e kanë ngritur në krah në mënyrë jo dinjitoze për të aksesuar qendrën e votimit.
2. Nuk kishte përparësi në rradhë si person me aftësi të kufizuar.
3. Dhoma e fshehtë ishte e papërshtatur, ishte lënë në një cep dhe nuk ishte vendosur siç duhet, pasi mesa duket komisionerët nuk e kishin kuptuar qëllimin e saj, për arsye të mos

trajnimin. Ankuesja është asistuar nga një person, i cili ka plotësuar fletën e votimit në lartësi, çka ka pamundësuar që ajo të kontrollojë nëse u përbush vullneti i saj.

4. Tek Pallati i Sportit “Asllan Rusi” ishin vendosur edhe gjashtë qendra të tjera votimi, çka sipas saj nënkupton se më shumë persona me aftësi të kufizuar janë ndjerë të diskriminuar dhe të përjashtuar.

Përsa më sipër, ankuesja, bazuar në nenin 33 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, kërkon nga Komisioneri:

- Konstatimin e diskriminimit të saj, si person me aftësi të kufizuar në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021 nga Bashkia Tiranë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si rezultat i mos plotësimit të kushteve në qendrën e votimit pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”;
- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësish së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet” për mos garantimin e kushteve për ekzistencën e mekanizmave të kontrollit për plotësimin e kushteve në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Subjekti ankues legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, të LMD-së. Subjekti legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të nenit 33, pika 4, gërma dh, të LMD-së.

¹Akronim për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ankuesja gjithashtu, legjitimohet *ratione materia*, pasi pretendimet e saj *prima facie*, janë të tilla që bëjnë pjesë në kompetencat që ligji, i njeh Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, gërma b, të LMD-së, si dhe ankuesja ka provuar interesin e saj të drejtëpërdrejtë për sa i takon pretendimit për cënim të parimit të barazisë e trajtimit në mënyrë të barabartë me votuesit e tjerë me të cilët krahasohet.

Përsa më lart, referuar neneve sipërcituar të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 713/1 prot., datë 18.05.2021 nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Bashkisë Tiranë, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e ankueses.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Tiranë me anë të shkresës² nr. 20072/1 prot., datë 27.05.2021, ka përcjell për kompetencë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, trajtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë nga S. L.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës³ nr. 5368/1 prot., datë 10.06.2021, ndër të tjera sqaroi se: “...Lidhur me ankimin e S. L. në të cilin pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ju bëjmë me dije se këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara. Lidhur me pretendimet e ankueses ju sqarojmë se, KQZ jo vetëm që nuk është angazhuar qëllimisht për mosrespektimin e garancive dhe lehtësirave për të drejtën e votës së personave me aftësi të kufizuara, por përkundrazi, ndër vite tashmë, është kujdesur maksimalisht dhe vazhdon të kujdeset për një garantim sa më të madh ligjor dhe faktik, të së drejtave të parashikuara në legjislacionin zgjedhor për ushtrimin e së drejtës së votës të personave me aftësi të kufizuara. Në mbështetje të sa më sipër ju rendisim të gjitha masat e ndërmarra dhe veprimet e kryera nga institucioni i KQZ-së lidhur me garantimin e së drejtës së votës për PAK, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Komisioni Rregullator në KQZ, ka miratuar në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor, Udhëzimin nr. 1, datë 5 Dhjetor 2020, ‘Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet’, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave që ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 713/2 prot., datë 02.06.2021

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 713/3 prot., datë 10.06.2021.

të votimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar. Në përputhje me parashikimet e nenit 108 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 1, datë 15.12.2020 të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, qendrat e votimit janë caktuar nga kryetari i bashkisë dhe janë organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për zgjedhësit të cilët nuk mund të votojnë vetë.

KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, ka pajisur komisionet e qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur.

Lidhur me pyetjen tuaj, nëse anëtarët e QV-ve janë trajnuar apo jo në lidhje me procedurat e votimit që ndiqen për personat me aftësi të kufizuara, ju bëjmë me dije se, në datat 18-23 Prill 2021, është realizuar trajnimi i KQZ-së me të gjithë anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, të ngritura për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ku pjesë e kurrikulës trajnuese ka qenë edhe udhëzuesi 'Për miratimin e udhëzuesit të Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021' i miratuar me vendimin nr. 16, datë 12.04.2021, nga Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Pjesë e këtij udhëzuesi në veçanti dhe e gjithë kurrikulës trajnuese në përgjithësi, kanë qenë edhe procedurat e votimit të parashikuara në nenin 108 të Kodit Zgjedhor, të zgjedhësve, që për arsye fizike nuk janë në gjendje t'i kryejë vetë ato, apo rastet kur nga zgjedhësi për leximin e fletës së votimit, kërkohet përdorimi i shabllonit 'braille'.

Sa i përket standarteve të dhomës së fshehtë për personat me aftësi të kufizuara, ju informojmë se:

Me vendimin nr. 2, datë 16.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar modelin dhe specifikimet e dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, para dhe tetraplegjikë, modeli i dhomës së fshehtë ishte i përshtatur për nevojat e tyre. Ky model i dhomës së fshehtë, i përshtatur për nevojat e zgjedhësve që i përkasin këtij grupimi, vjen si rezultat i konsultimeve edhe me organizata civile, përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara të cilat i mundësojnë këtyre zgjedhësve të ushtrojnë vetë të drejtën e votës, duke garantuar fshehtësinë e saj...

Bashkia Tiranë, ka dërguar në KQZ ashtu sikurse dhe Kodi Zgjedhor përcakton, listën e personave me aftësi të kufizuara për të gjitha njësitë administrative të kësaj bashkie, numri i të cilëve, në total për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ishte 11.948 zgjedhës.

Ju bëjmë me dije gjithashtu se, deri më tani, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk është paraqitur asnjë ankesë nga ana e ndonjë personi me aftësi të kufizuara, për mosrespektim të së drejtës së tij të votës, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, apo për diskriminim të tij në momentin e ushtrimit të kësaj të drejte.

KQZ, në zbatim të ligjit zgjedhor, ka mundësuar prodhimin e spoteve publicitare, shoqëruar me gjuhën e shenjave për të bërë të mundur informimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara dhe të verbër dhe ka zhvilluar takime me përfaqësues të shoqatave të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, me të cilët është diskutuar mbi nevojat dhe plotësimin e tyre ditën e votimit. Si

në çdo zgjedhje, edhe për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, fleta e votimit është shoqëruar me alfabetin 'braille' për të verbërit.

Për të pasur akses në informacion, KQZ ka mundësuar edhe publikimin e informacionit të plotë mbi veprimtarinë e këtij institucioni në faqen zyrtare të internetit, si dhe në të gjitha rrjetet e saj sociale.

Për sa më sipër, ju informojmë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me veprimet dhe mosveprimet e tij, jo vetëm që nuk ka penguar personat me aftësi të kufizuara për të ushtruar të drejtën e tyre legjitime të votës, por ka marrë të gjitha masat, objektivist të mundura për të përmbushur me rigorozitet të gjitha parashikimet ligjore dhe nënligjore, për garantimin e kësaj të drejte...”

Në përfundim, Njësia Administrative Nr. 7 Tiranë, me shkresën⁴ nr. 1828/1 prot., datë 18.06.2021, sqaroi ndër të tjera se: “...Caktimi i qendrave të votimit për zgjedhjet e datës 25.04.2021 është bërë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 298, datë 10.09.2020 ‘Për Procedurat e Hartimit të Listave të Zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë’ të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 31584, datë 18.09.2020, ‘Për ngarkimin e detyrave të përgatitjes së listave të zgjedhësve, caktimit të zonave dhe vendndodhjeve të qendrave të votimit si dhe bashkimin dhe/ose ndarjen e tyre, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë’. Neni 62, “Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit. Vendodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur.

Në Njësinë Administrative, Njësia Bashkiake Nr. 7, u ngritën 82 qendra votimi nga të cilat 79 qendra votimi në ambiente publike me hyrje të lirë, në institucione publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore dhe 3 (tre) Qendra votimi në ambiente private.

Për sa më sipër S. L. shpreh shqetësimin e saj lidhur me rampën në Pallatin e Sportit ‘Asllan Rusi’ ku ndodhej QV 1887/1 ju bëjmë me dije se: QV 1887/1 me vendodhje Pallati i Sportit ‘Asllan Rusi’ është e pajisur me rampë...”

2. Mbështetur parashtrimet e sipërcituara me Urdhërin nr. 103, datë 15.07.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë ambjentëve të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” Tiranë, më datë 22.07.2021, për të administruar informacionin e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së S. L.

Grupi i inspektimit të Komisionerit, mori takim me shtetasin S. D., me detyrë Specialist për Urbanistikën në Njësinë Administrative Nr. 7 Tiranë.

Gjatë inspektimit, nga përfaqësuesi i Njësisë Administrative Nr. 7 Tiranë, u sqarua se: “...Fillimisht jemi bërë me dije nga Bashkia Tiranë për të përcaktuar qendrat e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021. Nga ana e Bashkisë Tiranë është kërkuar vendosja e

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 713/4 prot., datë 01.07.2021.

qendrave të votimit në katet e para të ndërtesave, ndarja e personave me aftësi të kufizuara sipas qendrave të votimit. Në bashkëpunim me DPN 3 (institucion në varësi të Bashkisë Tiranë), është siguruar infrastruktura e nevojshme zgjedhore. Në këtë kuadër, do të verifikoheshin qendrat e votimit për ekzistencën e rampave dhe për të cilat iu kërkua DPN3 që në rastet kur nuk kishte rampa të vendoseshin provizore. Të 82 qendrat e votimit, kanë qenë të pajisura me rampë dhe nuk kemi patur probleme lidhur me to apo ankesa të paraqitura nga qytetarë të Njesisë 7. Nga Bashkia Tiranë nuk na është kërkuar të shohim nëse rampat i plotësojnë standardet e parashikuara në legjislacion.”

Në vijim nga grupi i inspektimit u realizuan foto të hyrjes së godinës së Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” dhe u evidentua që në hyrjen ballore të ndërtesës ndodhej një rampë për personat me aftësi të kufizuara, me përmasa si më poshtë:

- Lartësi 38 cm;
- Gjatësi 116 cm;
- Gjerësi 108 cm.

3. Nëpërmjet e-mailit, nga ana e Njesisë Administrative Nr. 7 Tiranë, më datë 26.07.2021, u sqarua ndër të tjera se:

“Në mbështetje të:

- *Ligjit 10019, dt. 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar. Kreu IV, Neni 62;*
- *Urdhërit nr.31584, dt. 18.9.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë;*
- *Korespondencës elektronike me Kordinatorin e Bashkisë Tiranë me Njësitë Administrative;*
- *Shkresave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;*
- *Kritereve teknike për përgatitjen e hartave të Njesisë së Vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet, në rastin tonë për hartën e Njesisë Administrative nr.7, bazuar në Udhëzimin nr.1, dt. 05 Dhjetor 2020;*

Njësia Administrative nr. 7, bazuar në sa përshkruam më sipër ka realizuar të gjithë procedurën, për zhvillimin normal të zgjedhjeve më dt.25.04.2021.

*Sa i takon situatës së përshtatshmërisë për aksesin e personave me aftësi të kufizuar, kemi kryer verifikimet **për ekzistencën ose jo** të rampave në objektet (QV) që ishin përcaktuar për zhvillimin e zgjedhjeve. Kështu është vepruar edhe për qendrat e votimit tek Pallati i sportit “Asllan Rusi”, ku për koçidencë janë zhvilluar disa zgjedhje radhasi, dhe objekti ka rampë për personat me aftësi të kufizuara.*

Ne konstatojmë se Institucionet publike kanë detyrimin ligjor që të kryejnë përshtatshmërinë për aksesimin e sigurtë për personat me aftësi të kufizuar.

Duke qenë pjesë integrale e Bashkisë Tiranë, i jemi drejtuar institucioneve në vartësi të saj për të kryer riparimet në qendrat e votimit në lidhje me ndriçimin, sigurimin e bravave të dyerve, sigurisë së dritareve dhe rampave për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuar”.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

A.1 Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm sa i përket aksesueshmërisë së jashtme të qendrës së votimit.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

S. L. në çështjen në objekt shqyrtimi është përfaqësuese e një organizate jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ankuesja pretendon se rampa në hyrje të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” është jashtë çdo standardi teknik të parashikuar në Rregulloren “Për përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara”. Pra, shumë e pjerrët dhe për rrjedhojë e papërdorshme dhe e rrezikshme.

Në arsyetimin e saj, ankuesja ka pretenduar se, duke qenë të vendosura në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi” edhe gjashtë qendra të tjera votimi, ka sjellë diskriminimin e votuesve me aftësi të kufizuara duke i përjashtuar ata nga e drejta për të votuar si të gjithë qytetarët e tjerë.

Në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvend dhe në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Rregullator në KQZ, ka miratuar Udhëzimin nr. 1, datë 05 Dhjetor 2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Në qëllim dhe objekt të tij, Udhëzimi i sipërcituar ka për qëllim përcaktimin e rregullave që ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit.

Neni 3 i Udhëzimit, parashikon Kriteret për përcaktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit, ku përcaktohet se:

“1. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për, arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, të Kodit Zgjedhor, kjo nuk është e mundur.

2. Qendrat e votimit krijohen:

a) për aq sa është e mundur në ndërtesa publike me hyrje të lirë;

b) në ndërtesa të institucioneve publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore ku përfshihen, shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore;

c) në institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë.

3. KQZ mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private, kur në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ- së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridikë. Propozimi paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ...”

Në nenin Neni 5 të Udhëzimit, përcaktohet se:

“1. Mjedisi i qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²;
- b) të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
- c) të jetë me ndriçim të mjaftueshëm;
- ç) të jetë në katet e para të objekteve.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr masa për instalimin e videomonitorimit në qendrat e votimit, në mënyrë të tillë që të mos çenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit.

3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:

- a) pajisjen e QV-së me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit, sipas skemës tip të plan vendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;
- c) vënien në dispozicion të Komisioneve të Qendrave të Votimit, të mjediseve të caktuara për qendra votimi, të pajisura me mjetet sipas parashikimeve të shkronjës “a” të këtij paragrafi, jo më vonë se 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve.”

Në përputhje me aktet e sipërcituara, Kryetari i Bashkisë Tiranë me Urdhërin Nr. 31584, datë 18.09.2020, ka urdhëruar Administratorët e Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë Tiranë, t’u ngarkohen detyrat:

1. Të nënshkruan të ekstrakteve të përbërësve zgjedhor dhe listës së zgjedhësve, caktimin dhe shpalljen e zonave dhe vendodhjen e qendrave të votimit, si dhe njoftimin e zgjedhësve, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë;
2. Bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit;

Në vijim, Kordinatori i Bashkisë Tiranë, nëpërmjet e-mailit⁵ ka informuar Njësinë Administrative Nr. 7, se: “...Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, i është përcjellë për kompetencë nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit shkresa me Nr. 2925/1 prot, datë 01.02.2021, dërguar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Nr. 483 Prot, datë 20.01.2021, nëpërmjet së cilës kërkohet përmbushja e detyrimeve që burojnë nga aktet

⁵ Vënë në dispozicion të KMD-së nga ana e përfaqësuesve të Njësive Administrative Nr. 7 Tiranë

ligjore dhe nënligjore, me qëllim organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më datë 25.04.2021... ”.

Nga informacioni i administruar dhe provat e vëna në dispozicion, nga ana e Njesisë Administrative Nr. 7, është përgatitur lista e zgjedhësve dhe numri i qendrave, së bashku vendndodhjen e tyre, të cilat janë përcjellë me shkresën Nr. 852 prot., datë 19.03.2021. Sipas parashtrimeve të përfaqësuesve të Njesisë Administrative Nr. 7, nga ana e tyre janë marrë masat për evidentimin e votuesve me aftësi të kufizuara dhe përcaktimin e qendrave të tyre të votimit në katet e para të ndërtesave. Sipas tyre, në qendrat e votimit ku ka patur zgjedhës me aftësi të kufizuara, janë evidentuar paraprakisht nëse ato plotësonin kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Referuar provave të administruara, ankuesja ishte caktuar të votonte në qendrën e votimit Nr. 1887/1, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” Tiranë. Bazuar në faktet dhe provat e administruara, rezultoi e provuar se, Pallati i Sportit “Asllan Rusi”, është një godinë e cila në hyrjen ballore të saj kishte 2 (dy) shkallë dhe në anën e majtë të tyre ishte e vendosur një rampë për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Nga inspektimi i kryer në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi”, u evidentua se përmasat e rampës që ndodhej në këtë godinë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara, ishin:

- Lartësi 38 cm;
- Gjatësi 116 cm;
- Gjerësi 108 cm.

Përsa më lart, nga përmasat e siguruara gjatë matjes së rampës dhe përlllogaritjes sipas Teoremës së Sinusit, u arrit të evidentohej se ajo kishte një pjerrtësi rreth 19° ose rreth 21 %.

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim **dhe shërbime** për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) *pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar* (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

Në pjesën e dytë të rregullores, kreun IV, nenin 8, pikat 2.10 dhe 2.11, përcaktohet se: “.....2.10. Para shkallës së parë dhe mbas asaj të fundit realizohet fusha relievore paralajmëruese në gjatësinë e plotë të krahut të shkallëve dhe me gjerësi 40 cm me vijëzime pingul me drejtimin e lëvizjes,2.11 “**Platformat e pjerrëta (rampat)**” - Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet: - pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%); - gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme; - shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës, - sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse; - rrethim të ndërtuar me doreza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi; - dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm; - rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike; - rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm; - përdorim i shenjave të përshtatjes Pjerrësia e platformave nuk duhet t’i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platformës.....”.

Referuar standarteve teknike që duhet të përmbushi rampa referuar rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, rezulton se duhet të kenë së paku:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme;
- sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
- rrethim të ndërtuar me doreza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
- dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike;
- etj...

Nga pamjet fotografike të administruara dhe matjet në terren të rampës që ndodhej në ambientet e jashtme të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, rezultoi se nuk përmbushen aspektet teknike të aksesueshmërisë, siç janë ekzistenca e vijave relievore që kanë si qëllim të drejtojnë dhe

orientojnë personat me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë. Mungesa e fushës relieveve paralajmëruese konstatohet nga pamjet fotografike të administruara edhe në pjesën e shkallëve, një aspekt teknik ky i detyrueshëm sipas parashikimeve të bëra në nenin 8, pika 2.10, të kreut I-rë të pjesës së dytë të rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi e provuar se rampa nuk përmbush edhe aspekte të tjera teknike më të domosdoshme të aksesueshmërisë, si p.sh.:

- pjerrtësia është më e madhe se ajo e përcaktuar nga neni 8, kreu VI, pjesa e II-të e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, në pikën 2.11 të saj;
- mungesa e rrethimit të rampës me doreza mbajtëse e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- gjerësia më e vogël se ajo e përcaktuar nga neni 8, kreu VI, pjesa e II-të e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, në pikën 2.11 të saj.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se Pallati i Sportit “Asllan Rusi”, dispononte në pjesën e përparme vendparkime për personat me aftësi të kufizuara, por nuk ishte i pajisur me një plan orientues për lëvizje në këtë ndërtesë, detyrim ky i parashikuar në nenin 18, të pjesës së dytë të rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ndërtesa e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” Tiranë, nuk përmbush të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Tiranë, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për të shprehur të drejtën e votës në zgjedhjet e datës 25.04.2021, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me zgjedhësit e tjerë.

A.2 Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm sa i përket aksesueshmërisë së dhomës së fshehtë të votimit.

Sa i përket pretendimit të subjektit ankues, lidhur me përshtatshmërinë e dhomës së fshehtë të votimit, Komisioneri nuk arriti të sigurojë prova dhe fakte nga palët në proces, nëse ato ishin

vendosur nga personat përgjegjës bazuar në kriteret e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër, Komisioneri nuk mund të shprehet nëse dhoma e fshehtë në qendrën e votimit të ankueses, apo në qendrat e tjera të votimit që ndodheshin në ambjentet e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” ishin të përshtatshme që personat me aftësi të kufizuara të shprehnin të drejtën e votës pa u asistuar nga individë të tjerë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 1, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, Komisioneri vlerëson se konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si të tillë në LMD dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se ajo e mbart këtë shkak.

Ankuesja ka pretenduar se situata e krijuar sa i përket mungesës së aksesueshmërisë në godinën e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, përbën mohim të barazisë për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, duke sjellë si pasojë trajtim të pabarabartë të personave me aftësi të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të votuesve. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diferencat në trajtim që bazohen në aftësinë e kufizuar, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e

⁶ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KDKPAK.

Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por ka përparësi ndaj rendit tonë juridik.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paafësia/paafësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit etj.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”* në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

Në nenin 29, të të KDPAK, përcaktohet se: “Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër:

(a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:

(i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;

(ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, në rastet e përshtatshme;

(iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre...”

Në kontekst të interpretimit të bërë nga ana e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shtetet palë të kësaj konvente marrin përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me mosdiskriminimin dhe ruajtjen e barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Në interpretim të nenit 29, të kësaj Konvente, shtetet palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur pa diskriminim.

Gjithashtu referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në lidhje me përshtatjen e arsyeshme, ndër të tjera theksohet që:

“Përshtatja e arsyeshme” është një pjesë përbërëse e detyrimit për mos-diskriminim, detyrim ky i cili i nënshtrohet realizimit të menjëhershëm.

Detyrimet mbi përshtatjen e arsyeshme janë të ndryshme nga ato të aksesueshmërisë. Që të dy synojnë të garantojnë aksesin, por detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrim *ex ante*, ndërsa detyrimi për të siguruar përshtatje të arsyeshme është një detyrim *ex nunc*.

Detyrimi për të siguruar përshtatje të arsyeshme në përputhje me nenet 2 dhe 5 të Konventës mund të ndahet në dy pjesë përbërëse. Pjesa e parë imponon një detyrim ligjor pozitiv për të siguruar një përshtatje të arsyeshme, i cili është një modifikim ose rregullim që është i domosdoshëm dhe i përshtatshëm, kur kërkohet në një rast të veçantë, për të siguruar që një person me aftësi të kufizuara mund të gëzojë ose ushtrojë të drejtat e saj ose të tij. Pjesa e dytë e

kësaj detyre siguron që ato përshtatje të kërkuara të mos imponojnë një barrë disproporcionale ose të panevojshme mbi subjektet e detyruara.

Detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, nuk duhet të ngarkojë personat me aftësi të kufizuara me shpenzimet e nevojshme për realizimin e përshtatjes. Gjithashtu, Komenti i Përgjithshëm nr. 6 (2018) vendos theksin tek fakti se barra e provës i takon subjektit që mbart detyrimin dhe që pretendon se barra e tij/saj do të ishte joproporcionale ose e padrejtë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45, pika 1 të saj, ka sanksionuar se: “Çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve (neni 5/1).

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe aksesin në shërbime.⁸

Duke mbajtur parasysh detyrimin që Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ka vendosur për shtetet, jo vetëm për të miratuar të gjitha masat e duhura legislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga Konventa, por edhe për të marrë të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, ka përcaktuar në nenin 20 se: “Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.”

Gjithashtu neni 1⁹ Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara më ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) e autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njuh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik¹⁰.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

⁸Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”parashikon: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.*”

⁹Neni 1, Protokollin 12 i KEDNJ, parashikon shprehimisht: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

¹⁰Shih Sejdic dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës (2009); Savez Crkava “Rijec Zivota” dhe të tjerët kundër Kroacisë nr. 7798/08, § 58, 9 dhjetor 2010);

Bazuar në nenin 3/9 të LMD, të ndryshuar: “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, siguron mbrojtje të individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku;

b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;

d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim;

dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;

....

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti

diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit... ”

Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kreun IV, Neni 62, pika 4 e në vijim, përcakton se:

“...4. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

6. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1,000 zgjedhës dhe lista është ndarë 32 sipas nenit 51 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërtohet sipas sistemit unik kombëtar të numërimit të qendrave të votimit.

7. ...

8. ...

9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

10. Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësisive të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me to... ”.

Në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Rregullator në KQZ, ka miratuar Udhëzimin nr. 1, datë 05 Dhjetor 2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Në nenin 1 të tij, parashikohet se: “Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Në nenin Neni 5, pika 3, të Udhëzimit, përcaktohet se:

“3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:

- a) pajisjen e QV-së me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit, sipas skemës tip të plan vendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;
- c) vënien në dispozicion të Komisioneve të Qendrave të Votimit, të mjediseve të caktuara për qendra votimi, të pajisura me mjetet sipas parashikimeve të shkronjës “a” të këtij paragrafi, jo më vonë se 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve...”

Në rastin konkret, edhe pse Bashkia Tiranë ka qenë në dijeni të faktit që referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, duhet t'i krijoheshin kushtet për të aksesuar qendrat e votimit në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk ka marrë masa për sigurimin e elementëve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, edhe për ankuesen, Bashkia Tiranë nuk ka marrë asnjë masë për vendosjen e qendrës së saj të votimit në një godinë e cila ka akses të plotë për personat me aftësi të kufizuara ose krijimin e kushteve për të ushtruar të drejtën e votës në qendrën e votimit në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi”, duke i siguruar elementët e nevojshëm të aksesueshmërisë. Pra, në këtë kuptim, Bashkia Tiranë nuk ka arritur të zbatojë legjislacionin e sipërcituar, sa i përket ushtrimit të së drejtës së votës në kushte të barabarta me votuesit e tjerë, për personat me aftësi të kufizuara.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Referuar në nenin 6 të këtij ligji, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Bazuar në nenin 33 pika 7/1 “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Gjithashtu, referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në lidhje me përshtatjen e arsyeshme, ndër të tjera theksohet që personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të jenë ata që të mbajnë kostot dhe barra e provës për të treguar që barra është joproporcionale apo e padrejtë është e ofruesit të shërbimit.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është evidentuar tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS¹¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

¹¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹²

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve më aftësi të kufizuara duhet t'i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situatë janë ndërmarrë hapa për t'i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Rezulton që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Bashkia Tiranë, kanë shprehur vullnetin e tyre për t'i siguruar aksesueshmërinë në qendrat e votimit personave me aftësi të kufizuara duke miratuar Udhëzimin e KQZ-së Nr. 1, datë 05.12.2020 dhe Urdhrin Nr. 31584, datë 18.09.2020. Referuar akteve të sipërcituara detyrimi për të vendosur qendrat e votimit në godina që kanë aksesin e nevojshëm për votuesit me aftësi të kufizuara, është i organeve të vetëqeverisjes vendore, pra i Bashkisë Tiranë në rastin konkret.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Bashkia Tiranë, kundrejt shtetases S. L. dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Tiranë duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Bashkia Tiranë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion lidhur me hapat konkret të ndërmarrë, për ofrimin e mundësisë ankueses apo personave me aftësi të kufizuara, të cilët votonin në qendrat e votimit, Pallati i Sportit "Asllan Rusi", për ti siguruar kushtet e përshtatshme të aksesueshmërisë, për të ushtruar të drejtën e votës;
- Pavarësisht faktit që godina e Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", kishte të vendosur një rampë, ajo nuk plotësonte kriteret minimale të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Njësia Administrative Nr. 7, vërehet se në godinën e Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", kanë qenë të vendosura 6 qendra votimi, në të

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

cilat ushtronin të drejtën e votës 31 (tridhjetë e një) persona me aftësi të kufizuara. Në këtë kuptim, mund të prezumohet se nuk kanë ushtruar të drejtën e votës në të njëjtat kushte me votuesit e tjerë.

Gjatë procedurës të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk u parashtrua asnjë pretendim në lidhje me faktin, nëse ofrimi i përshtatjes së arsyeshme për rastin e ankueses apo votuesve të tjerë me aftësi të kufizuara, përbënte një barrë disproporcionale dhe të padrejtë, pra një barrë të tepruar, edhe pse ligjërisht është detyrim i saj. Në këtë kuptim dhe referuar legjislacionit të analizuar më sipër, janë pikërisht organet e vetëqeverisjes vendore ato të cilat kanë detyrimin për ti ofruar përshtatjen e arsyeshme dhe aksesueshmërinë e nevojshme, personave me aftësi të kufizuara të cilët duhet të ushtrojnë të drejtën e votës.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Tiranë nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesja, që është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e Bashkisë Tiranë, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankueses dhe personave që ndodhen në kushte të njëjta me të, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprimeve dhe mosveprimeve ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Rezultoi se, Bashkia Tiranë, në cilësinë e autoritetit, i cili duhet të siguronte aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka marrë asnjë masë lidhur me këtë. Sigurimi i qendrave të votimit me aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, është e vetmja mënyrë që ankuesja dhe votuesit e tjerë në të njëjtat kushte me të do të mund të ushtronin të drejtën e votës në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykon se kërkesa për sigurimin e elementëve të aksesueshmërisë është një përshtatje e domosdoshme për ankuesen dhe personat të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të. Në kushtet kur rezultoi se vendosja e elementëve të aksesueshmërisë në godinën e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, nuk përbën një barrë të tepruar, për Bashkinë Tiranë, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Tiranë e ka vendosur ankuesen përballë një situatë diskriminuese, jo vetëm duke mos i siguruar elementët e aksesueshmërisë në qendrën e votimit, por edhe duke konsumuar diskriminim në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Tiranë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të, sa i përket aksesueshmërisë dhe mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetas S. L. dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, në formën e mohimit përshatjes së arsyeshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të S. L. dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të aftësisë së kufizuar.
3. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, në zgjedhjet e ardhshme, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Tiranë, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse.
4. Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e kriterëve, sa i takon personave me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme.
5. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

6. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)
(Forma: Mohim i përshtatjes së arsyeshme)